



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.135/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur.

### A r s y e t i m

Me datën 06.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën pretendon se me datën 05.10.2017 kandidati për kryetar të komunës së Ferizajt nga LDK Muharrem Sfarqa rreth orës 19:00 ka shkelur rregullën zgjedhore 13/2013 nenin 5.2, duke përfshirë persona nën moshën 18 vjeçare në një postim publik në faqen e tij publike në facebook gjatë fushatës së realizuar në Ferizaj ku në këto foto vërehen një numër i konsiderueshëm i personave nën moshën 18 vjet.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik LDK, në përgjigje në ankesë të datës 07.10.2017, e konsideron si të pabazuar ankesën për faktin se nuk ka asnjë shkelje nga kandidati për kryetar komune pasi që kandidati në kalim e sipër ka bërë një foto me disa fëmijë dhe të njëjtin e ka postuar në facebook por që postimi nuk përmban asnjë përmbajtje që ndërlidhet me zgjedhjet. I njëjti i propozon PZAP-it që ankesa në fjalë ta refuzoj si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore se në aktivitetet e kandidatit për kryetar komune në Ferizaj nga subjekti politik LDK janë përfshirë fëmijët e moshës nën 18 vjet, Paneli gjeti se këto pretendime janë të paqëndrueshme pasi që nga fotografit që gjenden në shkresat e lëndës nuk ka asnjë element të fushatës zgjedhore nga postimi i bërë.

Andaj, paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme parashkrimet se është bërë fushatë zgjedhore me fëmijë nën moshën 18 vjet nga ana e kandidatit të subjektit politik LDK. Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nënin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL. Anr.135/2017 më datën 10.10.2017.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.